

## SKEDË TEKNIKE

### RÖFIX Renofinish®

Rinovues dhe masë lëmuese universale



#### Fushat e përdorimit

Rinovues mineral-dhe masë lëmuese për zona universale përdorimi. Shpeshësia e aplikimit 1 në 2 mm. Masë përforcuese gjatë sanimeve të suvave të fasadave në kombinim me rrjetën përforcuese RÖFIX P50. Për punimin e sipërm të suvave bazamenteve të zakonshëm të ndërtimit me aftësi mbajtëse Shpatullues për sipërfaqet e objekteve minerale. Sipërfaqet e suvasë janë në përputhje me Skedën e "Sipërfaqeve prej suvave në zonën e brendshme, Shoqata Federale Gjermane e industrisë së gipsit në Berlin, Viti 2011" dhe ÖNORM B3346:2012 e ekzekutueshme në nivelet e cilësisë Q1 deri Q3. Nuk është i përshtatshëm përdorimi në sistemin e termoizolimit. Të mos përdoret në zonën e xokolaturës dhe në zonat në kontakt me ujin. Lëndë ndërtimi minerale sipas shtojcës A të katalogut për masat ekologjike për kërkesat në ndërtimin e shtëpive


#### Karakteristikat

- Përpunim i shkëlqyer
- Aftësi e mirë lëmimi
- Ngjitje shumë e mirë
- Të kurrje e ulët, SR1
- i lëmueshëm
- Rezistent ndaj fshirjes

#### Përpunimi



#### Të dhëna teknike

Numri i artikullit	42446
EAN	9003304424467
Paketimi	
Sasi për njësi	25 kg/Nj.
Njesi per palete	48 Nj./Pal
Madhësia e kokrrizave	0-0,1 mm
Zgjedhja e ngjyrave	E bardhë natyrale
Konsumi	ca. 1 kg/m <sup>2</sup> /mm
Udhëzime për përdorimin	Të dhënat mbi konsumin janë orientuese, ato varen shumë nga karakteristikat e bazamentit dhe nga teknika e aplikimit. Kur zhvillohet punimi për herë të parë dhe në raste të aplikimit në sipërfaqe të mëdha këshillohet realizimi paraprakë në një sipërfaqe prove.
Konsumi i ujit	ca. 25 m <sup>2</sup> /Nj./mm
Prodhimi i litrave	19,25 L/Nj.
Njësia e kërkesës për ujë	ca. 9,25 L/Nj.
Reaksioni ndaj zjarrit	A1
Kapilariteti	< 2 kg/m <sup>2</sup> *min0,5

## RÖFIX Renofinish®

Rinovues dhe masë lëmuese universale

Numri i artikullit	42446
Difuzioni i avullit të ujit	ca. 15
Hapja e difuzionit të avullit	Përshkueshmëri e lartë
Forca në lidhje	$\geq 0,08 \text{ N/mm}^2$
Forca në shtypje	2 N/mm <sup>2</sup> (7 d) EN 1015-11 4 N/mm <sup>2</sup> (28 d) EN 1015-11
Forca në përkulje	$\geq 2 \text{ N/mm}^2$
Përcjellshmëria termike	0,27 W/mK për P=50% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës) 0,3 W/mK für P=90% EN 1745:2002 (Vlera e tabelës)
Moduli-E	ca. 3300 N/mm <sup>2</sup>
Trashësia maksimale e shtresës	2 mm
Koha e tharjes	ca. 3 d
Masa vëllimore e llaçit të freskët	ca. 1800 kg/m <sup>3</sup>
Trashësia minimale e suvasë	1 mm
Grup llaçi	GP EN 998-1 CS II EN 998-1 Wc0 EN 998-1
Vlera e pH	12
Trashësia e shtresës	0-2 mm
Dendësia e shtresës niveluese	ca. 1000 kg/m <sup>3</sup> B 3345
Kapaciteti termik	ca. 1 kJ/kg K
Dëndësia në gjëndje të papërpunuar	ca. 1330 kg/m <sup>3</sup>
Temperatura nëntokësore	5-25 °C
Këshilla për paketimin	Në thasë letre me mbrojtje kundër lagështisë.

### Baza e materialit

- Lidhës dispersiv
- Gëlqere e pashuar
- Pluhur mermeri
- Përbërës organik < 5%
- Çimento e bardhë (pa kromate)
- Aditivë për përmirësimin e vetive të përpunimit

### Kushtet e punimit

Gjatë fazës së përpunimit dhe tharjes, ambjenti përreth sikurse dhe temperatura e bazamentit nuk duhet të bjerë nën +5 °C dhe të ngrihet mbi +30 °C. Gjatë kohës së aplikimit dhe forcimit të materialit, mbrojeni minimumi për 7 ditë nga ngricat.

# RÖFIX Renofinish®

Rinovues dhe masë lëmuuese universale

## Bazamenti

Bazamenti duhet të jetë i thatë, pa pluhura, pa ngrica, absorbues, i niveluar, me aftësi thithëse dhe mbajtëse, i lirë nga myqet dhe substanca ndarëse si yndyrnat etj. Testimi i bazamentit duhet të vijojë sipas ÖNORM B3346 ose DIN 18350 ose SIA V242. Pjesë suvave të dëmtuara eliminohen. Pjesë të liruara ose të shkëputura në ndërtesa të vjetra të mbrojtura nga shteti, pastrojnë vetëm duke marrë një miratim nga zyra përkatëse. Nëse këto pjesë nuk do të pastrohen ose zëvendësohen, atëherë duhet të ngjitsin përsëri në mënyrë profesionale. S bazamente të pershtatshme dallohen betoni, suvaja e poshtme apo pllaka mbajtëse të suvase si karton gipsi etj. Si bazamente janë të pershtatshme: Druri, gure natyrore dhe artificiale, mure dhe punime muri me tulla, suva beton dhe gips.

## Bazamenti-Trajtimi paraprak

Suvatë apo shtresat e bojës pa aftësi mbajtëse duhet të eliminohen. Mbi sipërfaqe betoni të pastra dhe të thata nuk është e nevojshme lyerja me lende lidhëse (ngjitese).. Në bazamentet organike pastrimi duhet të kryhet me anë të hedhjes së ujit dhe jo me anë të pastruesit me presion të lartë. Pas pastrimit lëreni bazamentin të thatet mjaftueshëm (rreth 10 ditë në kushte të mira atmosferike). Nëse bazamentet organike pastrohen me ujë me presion të lartë, koha e tharjes në këte rast zgjatet. Bazamentet me qëndrueshmëri të ulët ,me tendencë për të rënë mund të rigjenerohen ose të fortësohen me RÖFIX ujë gëlqeror ose RÖFIX PP 201 SILICA LF fiksues me silikat dhe hollues. Mbi sipërfaqe betoni të pastra dhe të thata nuk është e nevojshme lyerja me lende lidhëse (ngjitese)..

## Përgatitja

Në rast punimi me dorë përzieni një thes në makinerinë përzjerëse me sasinë e nevojshme të ujit , në mënyrë që të formohet një masë e njëtrajtshme. Pas përzjerjes lëreni 10 min. në qetësi dhe pastaj përzihen përsëri. Nëse materiali është fortësuar nuk përzihet më.

## Keshilla per perpunimin

Llaçin e freskët punojeni brenda 2 orëve. Gjatë tharjes duhet të përdorni mjete për ngrohjen- që të krijohen kushte më të mira për tharjen dhe fortësimin (psh. me ventilues). Ngrohja e drejtpërdrejtë e suvasë nuk është e lejuar. Materialin i hapur më parë nuk duhet përdorur, gjithashtu mos e përzieni me materialin e ri. Mos lani asnjëherë vetëm me ujë Në varësi të lagështisë së ajrit dhe konsistencës së përpunimit mund të përftohen nuanca të ndryshme ngjyrash tek suvatë e gërvishtura me ngjyra, të cilat përkojnë me karakterin natyral të këtyre suvave të sipërme Në varësi të lagështisë së ajrit dhe emperaturës koha e lidhjes zgjat rreth 3 ditë. Koha e tharjes së plotë zgjat rreth 3 ditë. Sipërfaqe me shtresa të reja duhet të mbrohen deri në lidhjen e plotë nga ngarkesat e lagështisë përmes masat përkatëse Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

## Përpunimi

Lëmojeni dhe gdhëndeni suvanë mbushëse para ngurtësimit si tek suvaja e lëmuar. Pas lidhjes së plotë dhe tharjes së suvasë mbushëse hapeni dhe lëmojeni me shpatull suvanë e lëmuar.

Aplikimi bëhet në përgjithësi në dy shtresa, secila me trashësi rreth 1 mm. Shtresa e parë duhet të aplikohet me një konsistencë pak më të fort. Aplikimi me dy shtresa arrin një cilësi sipërfaqe të njëtrajtshme.

Nuk është i pershtatshëm për ngjitjen në sipërfaqe të mëdha të pllakave qeramike ose pllakave të gurëve natyrorë.

Shtrimi në sipërfaqe të vogla i pllakave në zona me rrjedhje ose lagje të pjesshme (si psh: kuzhina gatimi në ambiente shtëpie, tualete) është i mundur vetëm mbas një kohe tharje të mjaftueshme (4 javë). Në zona me lagështirë (si psh: sektore me rrjedhshmëri uji të vazhdueshme) nuk sugjerohet suvatë e gëlqeres.

Për një rregullim të mirë të klimës së shtëpisë ju rekomandojmë bojrat me difuzion avujsh dhe dioksid karboni si RÖFIX PE SESCO bojë me bazë gëlqere, RÖFIX PI 233 ÖKOSIL ose PI 262 ÖKOSIL PLUS. Gjatë lyerjeve me bojë të suvave me bazë gëlqere duhet të garantohet një përshkueshmëri e lartë ndaj avujve të ujit dhe dioksidit të karbonit. Prandaj koha e tharjes duhet të përcaktohet para lyerjes me bojë. Koha e tharjes për bojra silikati: së paku 4 javë Shtresat mbuluese, të cilat kryhen me suvanw mbushwse rinovuese RÖFIX, duhet të tregojnë një trashësi minimale prej 10 mm dhe të jenw gatshme për shtresw e bojw sw mwpsme. Shtresat mbuluese, të cilat kryhen me suvanw mbushwse rinovuese RÖFIX, duhet të

# ROFIX Renofinish®

Rinovues dhe masë lëmuese universale

tregojne nje trashesi minimale prej 10 mm dhe tw jenw gatshme pwr shtreswn e bojws sw mwpsme.

## Magazinimi

---

Magazinojeni në vende të thata mundësisht mbi paleta druri. Koha e magazinimit: min. 12 muaj sipas. Rregullores 1907/2006/EG, Aneksi XVII, në temperaturë +20 °C, 65 % lagështi ambjenti.

## Certifikatë

---



## Udhëzime teknike dhe ligjore

---

Gjatë aplikimit të produkteve tona, respektoni të dhënat në skedat teknike, të cilat janë në përputhje me standardet e përgjithshme dhe specifike të vendit, si dhe të merren parasysh rekomandimet e shoqatës kombëtare të specialistëve.

## Këshilla të përgjithshme

---

Kjo skedë teknike anullon dhe zëvendëson të gjitha versionet e mëparshme. Të dhënat e këtyre udhëzuesve teknike përkojnë me njohuritë dhe përvojën tonë praktike të deritanishme. Ky informacion dhe të dhënat janë përpiluar me kujdes dhe me ndërgjegje të plotë, por pa mbajtur përgjegjësi për vendime ose veprime plotësuese që mund të marrë vetë konsumatori. Të dhënat në veteve nuk provojnë asnjë lidhje ligjore ose detyrime të tjera anësore, dhe normalisht nuk e ndalojnë konsumatorin të testojë produktin për ato qëllime për të cilat edhe është prodhuar. Produktet ROFIX si dhe të gjitha materialet përbërëse, i nënshtrohen një kontrolli të vazhdueshëm, me anë të të cilit garantohet një cilësi e pandryshueshme. Stafi ynë është i gatshëm tju japë cdo ndihmë teknike në lidhje me përdorimin, përpunimin si dhe mund të ofrojë edhe trajnime praktike në lidhje me përdorimin e produkteve tona. Skedat tona teknike më të reja, me të dhënat aktuale, mund ti gjeni edhe në faqen tonë të internetit ([www.roefix.com](http://www.roefix.com)), ose mund të kërkojnë edhe pranë filjaleve rajonale në vënd. Informacione më të detajuara për sigurinë mund ti lexoni tek

skedat tona të sigurisë. Përpara aplikimit të produkteve, jeni të lutur ti lexoni me kujdes këto skeda.

Të gjitha të dhënat teknike të dhëna në këtë fletë produkti janë përcaktuar në kushte laboratorike.